



SHPLLJE PËR FURNIZIME DHE SHËRBIME

AKP e cila ka në Administrim të Drejtpërdrejtë Ndërmarrjen Shoqërore “Inex Sharr Planina ” Brezovicë
SHPLLË këtë:

FTESË PËR OFERTË

I. LËNDA E KONTRATËS

Ftesë për ofertë për incizimin dhe inspektimin e përgjithshëm të litarëve dha aparaturave te qendra e skijimit në Brezovicë

Incizimi i litarëve dhe inspektimi i përgjithshëm i aparaturave do të bëhet për teleferikët:

1. Livadhi i madh në sipërfaqe prej $1280 * 2 = 2560$ metra;
2. Qafa e ortekut në sipërfaqe prej $1428 * 2 = 2856$ metra;
3. Baqilla në sipërfaqe prej $301 * 2 = 602$ metra;
4. Treni lëvizës në hyrje $150 * 2 = 300$ metra.

Sipërfaqja totale në të cilën duhet të bëhet incizimi për të gjithë teleferikët është 6318 metra.

Aktivitetet që duhet të kryhen nga Operatorit Ekonomik në qendrën e skijimit në Brezovicë janë si në vijim:

1. Të bëhet kontrollimi teknik i litarëve dhe aparaturave në përputhje me EN 1709;
2. Të bëhet incizimi i litarëve me defektoskopin magnetik në përputhje me EN 12927;
3. Ri shikimi i dokumentacionit teknik;
4. Shqyrtimi i gjendjes së shtyllave dhe mbrojtjes nga korrozioni;
5. Të inspektohet funksionaliteti i stacionit startues poshtë dhe në stacionin fundor;
6. Të inspektohet funksionaliteti i pajisjeve elektrike, pajisjeve të sigurisë dhe pajisjeve matëse;
7. Të bëhen kontrollime tjera të parapara me udhëzimet teknike të përdorimit të teleferikut (ski – liftave), dhe
8. Kontrollimi dhe testimi i tokëzimit – rrufepritësve të shtyllave dhe komplet teleferikut.

Kërkesat teknike që duhet ti plotësoj operatori ekonomik:

1. Të ketë licencë valide për kryerjen e punëve të tilla të lëshuara nga autoritet e Republikës së Kosovës apo jashtë Kosovës;
2. Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Kosovës ose të jetë konzorcium me kompaninë e regjistruar në Kosovë ose të ketë përfaqësuesin fiskal bazuar në legjislacionin në fuqi;
3. Të ketë përvojë në kryerjen e këtyre aktiviteteve – referencat të domosdoshme, dhe
4. Të ketë staf të mjaftueshëm për kryerjen e këtyre aktiviteteve.

Pas përfundimit të punëve Operatori Ekonomik duhet të lëshoj një raport, ku do të bën konstatim të përgjithshëm mbi gjendjen e teleferikut dhe lejimin e punës për sezonit 2023/2024.

Periodha për kryerjen e këtyre aktiviteteve më së largu 15 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.



Operatori ekonomik fitues do të shpallet ai i cili i plotëson kriteret teknike dhe oferton me çmimin më të ulët.

Buxheti maksimal i lejuar për këtë aktivitet është 10,000.00 Euro.

AFATI KOHOR DHE VENDI PËR DORËZIMIN E OFERTAVE

Për tu njohur më afër me aktivitetet që do të kryhen Operatorët ekonomik mund të bëjnë vizitë te Qendra e Skijimit në Brezovicë çdo ditë punë nga data 12.10.2023 deri më 22.10.2023

Ofertat finale të cilat duhet të jenë në zarf të mbyllur, duhet të dërgohen më datën **23.10.2023** nga ora **13:15** deri në orën **14:15** në adresën e mëposhtme:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. Dritan Hoxha nr. 55, 10000 Prishtinë.

Ofertat do të hapen me datën **23.10.2023** në ora **14:20** në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rr. Dritan Hoxha nr. 55, 10000 - Prishtinë .

V. Përfaqësuesit legjitim të ofertuesve, mund të marrin pjesë me rastin e hapjes së ofertave.